

## **Relacion shpjegues i përmbajtjes së ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (datë 21 06 2016)**

Ky projektligj synon të rregullojë organizimin dhe funksionimin e sistemit të gjykatave në Republikën e Shqipërisë. Ai parashikon rregulla të plota, të qarta në lidhje me çështjet e parashikuara në të duke përfshirë të gjitha gjykatat e sistemit gjyqësor. Konkretisht në lidhje me përcaktimin e kompetencës tokësore të gjykatave, caktimin e seksioneve në gjykata, përcaktimin e përbërjes së trupave gjyqësore, hartën e gjykatave nën kompetencën e Këshillit të Lartë Gjyqësor; për organizimin e brendshëm në gjykata; funksionimin e administratës gjyqësore, si dhe statusin e punonjësve në gjykatë. Në ndryshim nga sistemi aktual i rregullimit të çështejeve të mësipërme ky ligj parashikon një sistem të konsoliduar nën kompetencën e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të rregulluar, zbatuar dhe mbikëqyrur në praktikë organizimin dhe funksionimin e punës në gjykata.

Roli i Ministrisë së Drejtësisë është zvogëluar në rol konsultativ. Kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë forcuar pas rekomandimeve ndërkombëtare (Projekti i KiE/BE “Mbështetje e BE/KiE-së për Eficiencën e Drejtësisë – MED”) për forcimin e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në administrimin gjyqësor.

Projekt ligji përbëhet nga më shumë se 90 nene, strukturuar në 6 kapituj të përberë nga seksione, siç do të trajtohen më poshtë:

**Kapitulli I** në përmbajtjen e tij ka nenet 1 deri në 9-të. Ky kapitull përmban dispozita të përgjithshme në lidhje me përkufizimin e termave të ligjit, parimet e ushtrimit të pushtetit gjyqësor, siç janë ai i ligjshmërisë, pavarësisë dhe paanshmërisë së tij; të drejtën e aksesit në gjykatë; parimin e bashkëpunimit dhe konfliktit të interesit. Në këtë kapitull prezantohen llojet e gjykatave që ushtrojnë pushtetin gjyqësor, si dhe parimet e shërbimit gjyqësor dhe statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë.

**Kapitulli II** përbëhet nga 3 seksione dhe përfshin nenet 10-22. Ky kapitull rregullon kompetencat tokësore, madhësitë e gjykatave, duke parashikuar kompetencën e KLGj për të krijuar një hartë të gjykatave. Risia e projektligjit në këtë drejtim është krijimi i gjykatave të përqëndruara. Më konkretisht ky kapitull rregullohet në seksionet si më poshtë:

***Seksioni I*** përbëhet nga nenet 10 deri në 16. Në këtë seksion përcaktohet kompetenca tokësore e gjykatave. Nuk ka asnjë standard uniform në Evropë se kush është kompetent për hartimin e hartës gjyqësore: në disa vende hartat gjyqësore krijohen nga një akt i legjislativ, në përgjithësi nga një akt legjislativ që kërkon një kuorum të ulët në Parlament, në disa të tjera nga ana e pushtetit ekzekutiv (për shembull në Francë, ku Kushtetuta i rezervon të drejtën legjislativ për të vendosur rregullat për krijimin e llojeve të reja të gjykatave, (megjithatë) përcaktimi i numrit, vendeve dhe kompetencat e çdo juridiksioni të krijuar, përcaktohen nga pushteti ekzekutiv). Aty ku harta gjyqësore është e krijuar me ligj, kuorumi është i ulët, ose është një i ashtuquajtur “dekret ligjor” (për shembull në Itali dhe Portugali), i cili është në fakt një akt legjislativ i qeverisë.

Duke marrë parasysh që në Shqipëri ligji për pushtetin gjyqësor është një ligj me shumicë “tre të pestat”, nuk u konsiderua e përshtatshme që të krijohen të gjithë komponentët e hartës gjyqësore me ligj, i cili nuk lejon fleksibilitetin e mjaftueshëm dhe

përshtatjen e nevojshme të vazhdueshme në zhvillimet social-ekonomike në shoqëri, si zhvillimi i infrastrukturës, zhvillimet demografike, ndryshimet politike-administrative, etj.

Për më tepër, organizimi dhe riorganizimi i hartave gjyqësore janë projekte afatgjata, të cilat kanë nevojë të sigurojnë mbledhjen e disa të dhënave mbi periudha më të gjata kohore, përfshirjen e disa aktorëve dhe qytetarëve. Në shumicën e vendeve Evropiane, një proces i tillë shtrihet në disa vite.

Prandaj, projekti propozon një qasje të dyfishtë: ai përcakton hartën gjyqësore vetëm për gjykatat e nivelit më të lartë, gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsioni dhe krimin të organizuar dhe gjykatën administrative të apelit të krijuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që e kanë selinë e tyre në Tiranë.

Për të gjitha gjykatat e tjera, ligji parashikon objektivat, kriteret dhe procedurën për përcaktimin e hartës gjyqësore. Kjo do t'i detyrojë autoritetet përgjegjëse të vlerësojnë çdo pesë vjet faktorët kyç dhe të zhvillojnë një hartë gjyqësore e cila, në një periudhë afatgjatë, do të reduktojë ndjeshëm numrin e lartë të gjykatave të vogla.

Ligji i jep Këshillit të Lartë Gjyqësor kompetencën për të kryer vlerësimet e rregullta dhe për të përgatitur propozimin për rishikimin e hartës gjyqësore pasi të ketë marrë mendimin e Ministrit të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministrit të Financave dhe këshillimit me aktorë të tjerë. Kjo është në përputhje me një opinion të Komisionit të Venecias, CDL-AD (2013) 034, i cili thotë se "organi më kompetent për hartimin dhe ndryshimin e rrjetit të gjykatës është Këshilli i Lartë Gjyqësor. [...], iniciativa për vendime të tilla duhet të vijë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sesa nga Presidenti.

Grupi i punës mori në konsideratë dy opsione në lidhje me kompetencën për të miratuar më në fund propozimin: Presidenti ose Këshilli i Ministrave. Pasi Këshilli i Ministrave mund të marrë një vendim vetëm të bazuar në propozimet e Ministrit, detyra për të propozuar hartën gjyqësore mund t'i caktohet Ministrit të Drejtësisë, pasi të ketë marrë pëlqimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe mendimin e aktorëve të tjerë dhe miratimin nga Këshilli i Ministrave. Pasi procedurat për të marrë pëlqimin mbajnë një rrezik të lartë të krijimit të situatave të ngërçit, ky opsion u rrëzua në favor të traditës aktuale shqiptare.

Kështu, ligji parashikon se propozimi dekretohet më pas formalisht nga Presidenti i Republikës. Kjo konsiderohet në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias, i cili propozon që këtë kompetencë t'ia caktojë më mirë Parlamentit sesa Presidentit (CDL-AD (2013) 034) (paragrafi 13), ose nëse Presidenti është i përfshirë, të reduktohet përfshirja e Presidentit në një përfshirje formale (CD\_-AD (2011) 033) (paragrafi 22).

Megjithatë, modeli i propozuar nevojitet të sigurojë në praktikë mbështetjen e fuqishme të ekzekutivit: Përcaktimi i hartës gjyqësore ka efekte të larta në buxhetin e shtetit, menaxhimi dhe përdorimi efikas i tij, i është caktuar nga Kushtetuta, qeverisë dhe jo Presidentit.

Po ashtu në këtë seksion në nenin 13 të tij parashikohet krijimi i hartës së gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve të jurisdiksionit të përgjithshëm të krijuara mbi bazën e rretheve gjyqësore.

Në nenet 14 dhe 15 parashikohen parimet se ku do mbështet KLGJ në caktimin e këtyre gjykatave, siç janë garantimii aksesist në drejtësi, ulja e kostove, rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimii gjyqësor. Po ashtu parashikohen dhe kriteret ku do bazohet KLGj për caktimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit që janë a) ai tokësor që ka të bëjë me zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport më numrine gjykatave, zhvillimin ekonomik, karakteristikat gjeografike dhe zhvillimin e rrugëve dhe transportit; si dhe b) kriteri i administratës gjyqësore duke u bazuar në tregues të veprimtarisë në lidhje me ceshtjet që gjykohen në gjykata.

Risia ka të bëjë me rritjen e numrit minimal të gjyqtarëve në përbërjen e një gjykate që duhet respektuar në rast krijimi të saj. Konkretisht në përbërjen e gjykatave të shkallës së parë duhet të ketë së paku 7 (shih fusnotën në projektligj: ose 12 gjyqtarë, u propozuan dy opsione) ndërsa në përbërjen e gjykatave të apelit duhet të ketë së paku 10 gjyqtarë (shih fusnotën: ose 15 gjyqtarë, u propozuan dy opsione).

Në përgjithësi, ligji parashikon një bazë ligjore për të kryer një reformë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të hartës gjyqësore në vitet e ardhshme. Kjo do të kërkojë një shqyrtim të kujdesshëm të alokimit të fondeve për investime në gjykata me balancimin e objektivave kontradiktore, si afërsia e gjykatave te qytetarët, përdorimi i kujdesshëm i burimeve publike si dhe efikasiteti dhe cilësia e sistemit të drejtësisë. Për më tepër, gjatë përcaktimit të rrethëve gjyqësore dhe kompetencave territoriale të gjykatave, parimi i barazisë, që do të thotë se të njëjtat kritere duhet të zbatohen për të gjitha rajonet, dhe parimi i proporcionalitetit duhet të merren parasysh, pra, sa më shumë të ndikojë një masë në aksesin në gjykatë, aq më e fortë duhet të jetë arsyeja e justifikimit, pra, përmirësimi i pritshëm i efikasitetit.

Projekt-ligji këtu reflekton standardet ndërkombëtare evropiane për të patur gjykata të përqëndruara me numër me të madh gjyqtarësh, në krahasim me sistemin aktual për ta bërë sa më efektiv dhe eficient.

### Madhësia e gjykatave

Në fakt, shumica e vendeve Evropiane po përqëndrojnë gjeografikisht funksionet gjyqësore, duke zvogëluar në këtë mënyrë numrin e gjykatave. Arsyet për këtë janë të ndryshme. Disa vende e bëjnë këtë për të rritur cilësinë e drejtësisë. Ky është rasti në Danimarkë, Norvegji dhe Holandë. Në vende të tjera, pritet që, përveç cilësisë më të lartë, mund të arrihet zvogëlimi i kostove duke mbyllur gjykatat më pak të përdorura dhe ndonjëherë edhe gjykatat e rrënuara dhe kalimin e çështjeve në gjykatat e afërta. Ky është rasti në Portugali dhe Greqi, por edhe në vende të ndryshme si Austria, Irlanda, Britania e Madhe, Polonia, Rumania dhe Turqia. Ashtu si Holanda, edhe Polonia e Turqia gjithashtu po synojnë të sjellin disa gjykata të vogla nën një ombrellë, për të reduktuar kostot e menaxhimit dhe ato operative në përgjithësi. Në vende të tjera, si Belgjika (320 gjykata) dhe Italia (1289 gjykata), rishikimi i hartës konsiderohet i nevojshëm, por konsensusi për masa specifike nuk është arritur ende, edhe pse në Itali kushtet ligjore për riorganizim janë krijuar (ENCJ Reforma Gjyqësore në Evropë, Raporti 2011-2012).

Një reformë e kohëve të fundit në Portugali që synon organizimin dhe funksionimin e gjykatave, bashkoi 308 gjykata në 20 gjykata të mëdha, që operojnë me degë të ndryshme në të njëjtin rreth. Reforma në përgjithësi është konsideruar si e suksesshme.

Sipas udhëzimit të CEPEJ-it, mbi krijimin e Hartave Gjyqësore në shtetet anëtare të BE-së (CEPEJ (2013) 7, 2.3.2 Madhësia e gjykatave) produktiviteti më i lartë në nivel Evropian është arritur në gjykatat me një numër të përafërt gjyqtarësh ndërmjet 40 dhe 80. Raporti i CEJ-it "Për Organizimin e gjykatave dhe kapacitetet e administratorëve të gjykatave në Shqipëri, 2016, rekomandon për Shqipërinë një madhësi minimale të gjykata nga 12 deri 14 gjyqtarë, për të mbështetur ndarjen efikase dhe të drejtë të çështjeve, përdorimin efikas të burimeve, cilësinë në drejtësi dhe të lejojë specializimin. Për të siguruar që harta gjyqësore de facto do të zvogëlojë numrin e gjykatave të vogla, ligji parashikon një numër minimal të gjyqtarëve për gjykatë.

Drafti parashikon dy opsione kryesore, të cilat do të vendosen nga ligjvënësi:

Një alternativë është që të parashikohet me ligj madhësia minimale e një gjykate të shkallës së parë, me të paktën 7 gjyqtarë, dhe në një gjykatë të apelit duhet të jenë të paktën 10 gjyqtarë. Kjo në fakt do të zvogëlonte numrin e gjykatave në 50%.

Një opsion tjetër do të ishte që të parashikohej si numri minimal i gjykatave numri 12 për shkallën e parë dhe numri 15 për nivelin e apelit, ku kjo duhet të shoqërohet me periudha më të gjata të tranzicionit për të siguruar një planifikim të dorës së gjatë të burimeve publike dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve të drejtësisë.

Lidhja me organizimin administrativ të vendit, si faktor kryesor:

Ligji lejon që të merret parasysh organizimi administrativ i Shqipërisë, kur të riorganizohet harta e gjyqësorit. Megjithatë, ky faktor është vetëm një nga faktorët që duhet të merren parasysh, krahas zhvillimit demografik, raportit të numrit të banorëve me numrin e gjykatave në një zonë të caktuar, dinamizmit ekonomik të zonës, rrugëve të udhëtimit dhe kohës mesatare të udhëtimit për në gjykata dhe midis gjykatave, karakteristikave gjeografike si dhe objekteve në dispozicion (shih nenin 15, paragrafi 3). Kjo konsiderohet në përputhje me opinionin e Komisionit të Venecias, CDL-INF (2000) 005, i cili sugjeron: "Në një demokraci të re [...] gjithësesi do dukej e preferueshme të shmangej një lidhje e tillë ndërmjet ndarjes administrative dhe organizimit të gjykatave, për ta bërë më të vështirë për administratën të ushtrojë ndikim të paligjshëm mbi gjykatat."

**Seksioni II** përbëhet nga nenet 17 deri në 20. Në këtë seksion parashikohet në ndryshim nga sistemi aktual krijimi i degëve të gjykatave me qëllim përqëndrimin e tyre dhe zgjidhjen e çështjeve që lidhen me delegimin e gjyqtarëve. Për të lejuar gjykata mjaftueshmërisht të mëdha, pa cënuar objektivin e afërsisë së qytetarëve në gjykata, ligji parashikon që të hapen degë të gjykatave si njësi administrative të gjykatave. Kështu, garantohet e drejta e aksesit në gjykata, duke qasur pranë qytetarëve në zona të caktuar shërbimet gjyqësore. Në varësi të studimit të situatës, bazuar në të njëjtat parime dhe kritere përcaktimin e gjykatave, KLGj krijon degët e gjykatave, të cialt janë dy llojesh, të përhershëm dhe të përkohshme. Po ashtu në këtë seksion parashikohen rregulla për caktimin e gjyqtarëve në degët e gjykatave.

KLGj është organi i ngarkuar nga projekt-ligji për të parashikuar rregulla më të detajuara për krijimin dhe funksionimin e degëve.

Ky model është përdorur gjerësisht në Evropë për të bashkërenduar objektivat kontradiktore. Reforma e fundit në Portugali ka krijuar që çdo gjykatë të ketë edhe disa degë, megjithatë, asnjë gjykatë (së bashku: selia qendrore dhe degët), me më pak se 40 gjyqtarë. Në Holandë psh, çdo gjykatë ka një numër mjedisesh në nën-qarqe.

Degët e gjykatave gjykojnë vetëm çështjet jo-urgjente, të cilat janë në kompetencë të një gjyqtari të vetëm. Përveç kësaj, në lidhje me çështjet civile, degët e gjykatave do të merren vetëm me çështje që lidhen me kontratat e blerjes, pa përfshirë çështjet e pronësisë, kontratat e qirasë, çështjet familjare dhe të punësimit. Kjo ndjek modelin Holandez, ku gjyqtari i nën-qarkut merret vetëm me kundërvajtjet e vogla e jo me shkelje të rënda. Shpesh, këto janë çështje për të cilat policia ose prokurori publik ka propozuar një zgjidhje. Nëse i akuzuari refuzon të pranojë një propozim të tillë, atëherë çështja paraqitet para gjyqtarit të nën-qarkut. Gjyqtari i nën-qarkut zakonisht jep një vendim me gojë menjëherë pas seancës. Ndërsa, përsa i përket të drejtës civile, gjyqtari i nën-qarkut merret me të gjitha çështjet që përfshijnë qiratë, blerjet me këste dhe punësimin.

**Seksioni III** përbëhet nga nenet 21 deri në 22. Në këtë seksion parshikohen rregulla në lidhje me caktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve, duke pasur parasysh kriteret e njëjtë si për caktimin gjykatave dhe degëve të tyre. Projekt-ligji cakton KLGj si organi që ka kompetencën të bëjë propozimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve për çdo gjykatë. Ky propozim do të jetë pjesë e propozimit për buxhetin e gjyqësorit, pasi numri i përgjithshëm i gjyqtarëve ka një ndikim të madh buxhetor. Gjithashtu, në këtë drejtim grupi i punës ka pasuar opinionin e Komisionit të Venecias, CDL-AD (2014) 031, i cili theksoi se organi i duhur për të bërë vlerësimin përfundimtar për numrin e ... gjyqtarëve dhe të nevojës për më shumë gjyqtarë, zakonisht është ligjvënësi ose Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke pasur parasysh se zgjedhja varet, ndër të tjera, në mjetet buxhetore në dispozicion.

Po ashtu projekt-ligji vendos detyrimin për KLGj që çdo 5 vjet të rishikojë numrin e gjyqtarëve për gjykatë në mbështetje të parimeve dhe kriteret e sipërrajtuara në seksionin II.

**Kapitulli III** përbëhet nga 4 seksione dhe përfshin nenet nga 23 deri në 39. Në këtë kapitull parashikohet organizimi i brendshëm i gjykatave. Konkretisht rregullohet mënyra e krijimit të seksioneve dhe trupave gjyqësore, organizimit të shortit për ndarjen e çështjeve me short. Projekt-ligji parashikon organet që kanë detyra që lidhen me organizimin dhe funksionimin e gjykatave duke parashikon për herë të parë organe të tilla si këshillat e gjykatave, mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve; si dhe organe tashmë ekzistues dhe që kanë ekzistuar me parë në sistemin gjyqësor siç janë Kryetari, Zv/Kryetari, Kancelari i Gjykatës. Po ashtu përveç rregullave të përgjithshme për të gjitha gjykatat në këtë kapitull, parashikohen rregulla të posaçme në lidhje me organizimin e Gjykatës së Lartë, si dhe Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Më konkretisht kapitulli rregullohet në seksionet si më poshtë:

**Seksioni I** përbëhet nga nenet 23 deri në 29. Në të parashikon krijimin e seksioneve dhe trupave gjyqësore në gjykatë. Kompetenca për t'i krijuar ato i është caktuar Këshillit të Gjykatës. Ndërsa sipas këtyre dispozitave KLGj përcakton rregulla të përgjithme për kriteret dhe procedurën e krijimit të seksioneve, trupave gjyqësore dhe caktimit të gjyqtarëve në to.

Ndërkohë projekt-ligji në nenin 24 duke reflektuar rregullimin ligjor aktual ka parashikuar numrin e gjyqtarëve që përbëjnë trup gjyqësor a) në gjykatën e shkallës të parë që është një gjyqtar ose janë tre gjyqtarë, përveç rasteve të tjera të parashikuara në ligj; b) në gjykatën e apelit dhe atë administrative të apelit që janë tre gjyqtar përveç rasteve të tjera të parashikuara në ligj. Ndërkohë në lidhje me gjykatën e posaçme kundër korrupsionet dhe krimin të organizuar parashikohet se në përbërjen e

trupave gjyqësore janë 5 gjyqtarë, përveç raste të tjera të parashikuar në ligj. Kjo është në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias, të cilat sugjerojnë se përbërja e trupit gjykues i lihet rregullave të procedurës (shih gjithashtu Komisioni i Venecias, CDL-AD (2013) 015).

Neni 25 i projekt-ligjit parashikon rregullim në lidhje me ndarjen e çështjeve gjyqësore me short, si dhe parimet se ku mbështet zhvillimi i shortit, që është transparenca dhe objektiviteti. (shih gjithashtu Komisioni i Venecias, CDL-AD(2010)004 or CDL-AD(2002)026). Sipas projekt-ligjit KLGj ka detyrimin të miratojë rregulla të hollësishtme në lidhje me procedurat e ndarjes së çështjeve me short. Nuk mund të jetë gjithmonë e mundur për të krijuar një sistem të plotë abstrakt gjithëpërfshirës që funksionon për të gjitha rastet, duke mos lënë vend për vendimet lidhur me shpërndarjen e çështjeve individuale. Përjashtimet e tilla duhet të përcaktohen paraprakisht në bazë të kriterëve objektive (shih gjithashtu CDL-AD (2012) 001): *"Mund të ketë rrethana që nxisin nevojën për të marrë në konsideratë ngarkesën e punës apo specializimin e gjyqtarëve. Sidomos çështjet komplekse ligjore mund të kërkojnë pjesëmarrjen e gjyqtarëve të cilët janë ekspert në atë fushë. Për më tepër, kjo mund të jetë diçka e kujdesshme që të vendosen gjyqtarët e sapo emëruar në një panel me anëtarë më me përvojë për një periudhë të caktuar kohe. Për më tepër, mund të jetë një veprim i matur, kur gjykatës i duhet të japë një vendim parimor në një rast të ndërlikuar ose të rëndësishëm, që gjyqtarët më të vjetër të caktohen në atë çështje."*

Po ashtu parashikohet se është kancelari i gjykatës që mbikëqyr organizimin e shortit. Caktimi i çështjeve i nënshtrohet inspektimit (dhe gjithashtu CDL-AD (2014)031) për të evituar abuzimin.

Neni 26 rregullon organin e Kryetarit dhe Zv/Kryetarit e Gjykatës. Ndërsa për Kryetarin e Gjykatës promovimin e tij ky projekt-ligj e referon në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; për atë të Zv/Kryetarit e parashikon si kompetencë e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve. Sërish parashikohet detyrimi i KLGJ për miratimin e rregullavë të hollesime për procedurën e zgjedhjes së Zv/Kryetarit të Gjykatës.

Në nenin 27 parashikohen organizimin dhe përbërjen e Këshillave të Gjykatës. Ky organ është risi në sistemin gjyqësor dhe vlerësohet si një organ që do garantojë mirëfunksionimin e gjykatës, garantojë efikasitetin dhe eficientë në realizimin e shërbimeve gjyqësore. Këshillat e gjykatave përbëhen nga Kryetari i Gjykatës, Zv/kryetari dhe kancelari. Një përbërje e tillë ndryshon në përputhje me qëllimin e mbledhjes së Këshillit të Gjykatës dmth, kur ai vepron si Komision Disiplinor në procedurat kundër kancelarit; kur ai ka për të vendosur mbi çështje të ndryshme nga ato disiplinore në lidhje me kancelarin, etj. Pasi rezultati i përgjithshëm i një gjykate varet shumë nga bashkëveprimi midis gjyqtarëve dhe stafit administrativ, është e rëndësishme që të ngrihet një sistem i aftë për të ndërtuar një përgjegjësi të ndarë midis kryetarit dhe administratorit të gjykatës për menaxhimin e përgjithshëm të detyrës (shih gjithashtu UNDOC, Udhëzues mbi Burimet për Forcimin e Integritetit dhe Kapacitetit Gjyqësor, menaxherët e gjykatës, faqe 4.). Kjo pason praktikën e përdorur gjerësisht në gjykatat Europiane (për shembull: Finlandë apo në Hollandë).

Ndërkohë në nenin 28 parashikohet mënyra e funksionimit të Këshillit të Gjykatës, i cili krysohet dhe thirret nga Kryetari i Gjykatës. Edhe në lidhje me këtë organ, projekt-ligji garanton parimin e transparencës se mbledhjeve së Këshillit të Gjykatës,

të cilat është e detyruar të regjistrohen dhe transkriptohen. Sipas projekt-ligjit KLGj ka detyrimin të miratojë rregulla për procedura të mëtejshme për procedurën e mbledhjes së këshillit të gjykatës.

Neni 29 parashikon menyrën e organizimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtrëve të gjykatës. Ajo thirret dhe kryesohet nga kryetari gjykatës. Zgjedh zv/kryetarin e gjykatës dhe diskuton analizën vjetore të gjykatës. Projekt-ligji garanton parimin e transparencës së mbledhjeve së Këshillit të Gjykatës, të cilat është e detyruar të regjistrohen dhe transkriptohen.

**Seksioni II** përbëhet nga nenet 30 deri në 36. Në këtë seksion parashikohen rregulla më specifike në lidhje me krijimin e seksioneve dhe trupave gjykues në Gjykatën e Lartë. Projekt-ligji parashikohen krijimin e seksioneve civile dhe penale si dhe çështjet që janë në juridiksionin e tyre. Parashikon se perbërja e trupave gjykuese në këtë seksione është me tre gjyqtarë, me përjashtim rastit kur kolegji penal gjykon çështje që janë në kompetencë të Gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këtë rast trupi gjykues I kolegjit penal parashikohet të përbëhet nga 5 gjyqtarë. Në këtë seksion parashikohen rregulla të detajuara sesi kryesohen trupat gjykues në seksione. Në nenin 32 të seksionit parashikohet kompetenca e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të gjykuar çështje që lidhje me njësimin e praktikës gjyqësore dhe zhvillimne saj; si dhe rastë të tjera të parashikuara në ligj.

Ne nenin 33 parashikohet rregulla për funksionimin, përbërjen dhe quorumin në vendimmarrjen e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në kuadër të organizimit të Gjykatës së Lartë në nenin 34 parashikon që çdo gjyqtar në Gjykatën e Lartë ndihmohet nga dy ndihmës magjistrat (që me sistemin aktual është ndihësi ligjor) duke parashikuar detyrat e tyre. Ne raport me ndihmësit ligjor aktual ky projekt-ligji sjell risinëse ndihmës magjistratët do të jenë magjistratë të komanduar në përputhje me ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe caktohen nga KLGJ.

Gjithashtu nisur nga rëndësia që ka publikimi i vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe praktikës së saj unifikuese projekt-ligji në nenin 35 të tij parashikon krijimin e qendrës së dokumentacionit pranë kësaj gjykate.

**Kapitulli IV** përbëhet nga 2 seksione dhe përfshin nenet 36-49. Projekt-ligji në këtë kapitull rregullon funksionimin e administratës së gjykatave duke parashikuar organizimin e administratës së gjykatës, si dhe kompetencat e detyrat e organeve të kësaj administrate. Po ashtu në këtë kapitull parashikohen dhe rregullohen shërbimet që realizohen nga administrate gjyqësore në favor të publikut. Më konkretisht kapitulli rregullohet në seksionet si më poshte:

**Seksioni I** përbëhet nga nenet 36 deri në 40. Në këtë seksion parashikohen kompetencat dhe detyrat në kuadër të administrative të gjykatës të KLGj, Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve, Këshillit të Gjykatës, Kryetarit, Zv/Kryetarit dhe Kancelarit të Gjykatës.

Neni 36 parashikon KLGj si organin më të lartë që vendos rregulla dhe mbikëqyr organizmin dhe funksionimin e shërbimeve në gjykata.

Neni 37 parashikon kompetencat e Kryetarit të Gjykatës sipas të cilave ai rezulton organi që ka përgjegjësi në menaxhimin e përgjithshëm të gjykatës.

Neni 38 parashikon detyrat e Këshillit të Gjykatës mes të cilave, bazuar në rregullat e vendosura nga KLGJ, miraton përshkrimet e punës të kategorive të nëpunësve civil gjyqësor në kuadër të organizimit të punës në gjykatë; miraton strukturën dhe organikën e gjykatës. Këshilli i Gjykatës e bazon këtë vendim mbi strukturën standarde të miratuar nga KLGJ, të cilën ai do ta përshtat me nevojat e gjykatës vetëm në çështjet e arsyetuara.

Neni 39 parashikon detyrat e Kancelarit, i cili është nën mbikqyrjen e kryetarit dhe që kanë të bëjmë me menaxhimin e administrimit gjyqësor të gjykatës. Ai merr vendime në lidhje me punonjësit e gjykatës që kanë status të nëpunësit civil gjyqësor si dhe në lidhje me punonjësit e tjerë. Kancelari ka detyra që kanë të bëjnë me menaxhimin e çështjeve në gjykatë.

Neni 40 parashikon kompetencat dhe detyra e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve. Konkretisht parashikohet ndër të tjera kompetenca për zgjedhjen e Zv/Kryetarit të Gjykatës, për diskutimin e raportit vjetor të gjykatës; si dhe diskuton çështje unifikues, vendimet e gjykatave me të larta, të Këshillit të Gjykatës.

Në përgjithësi, ndarja e detyrave udhëhiqet nga disa rekomandime të paraqitura nga Komisioni i Venecias në këtë drejtim, në veçanti nga:

- Caktimi i Këshillit Gjyqësor me mbikqyrjen e administrimit të gjykatave (CDL-AD (2014) 038)
- Shmangia e përfshirjes së ekzekutivit (Ministritë së Drejtësisë), në miratimin e rregulloreve të gjykatave për funksionimin dhe procedurën e brendshme (CDL-AD (2013) 015);
- Shmangia e dhënies së kompetencave Ministritë së Drejtësisë mbi gjyqësorin, të tilla si detyrimi i kryetarit të gjykatës për t'i dhënë Ministritë së Drejtësisë raportin e aktivitetit të gjykatës, dhe, me kërkesë të Ministritë së Drejtësisë, t'i dorëzoj raportet e veçanta apo raportet periodike të cilat janë të nevojshme për kryerjen e detyrave që bien nën juridiksionin e tyre, pasi këto detyrime të tilla duket sikur e vënë kryetarin e gjykatës në një pozitë nënshtrimi ndaj Ministritë së Drejtësisë (CDL-AD (2014) 038)
- Kufizimi i rolit mbikëqyrës të Ministritë së Drejtësisë duke shmangur caktimin e funksioneve mbikëqyrëse Ministritë së Drejtësisë për kryerjen e detyrave administrative në gjykatë, si mundësia e Ministritë së Drejtësisë për të kryer inspektime në gjykata, për shembull, në lidhje me organizimin e punës në gjykata, duke vepruar nisur nga kërkesat dhe ankesat e qytetarëve ndaj punës së gjykatave, ose në lidhje me punën e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, konkretisht, aktivitetet e tij në lidhje me administrimin e gjykatave ose të punës së nëpunësve dhe arkivat (CDL-AD (2014) 038)

**Seksioni II** përbëhet nga nenet 41 deri në 49. Në këtë seksion parashikohen rregulla mbi administrimin e brendshëm gjyqësor duke konsoliduar në një ligj të vetëm rregullat në lidhje me shërbimet që kryen administrata gjyqësore. Në nenin 45 klasifikohen dhe përshkruhen këto shërbime në tre lloje atë gjyqësor, administrativ, dhe mbështetës.

Neni 42 parashikon një risi, figurën e ndihmësit ligjor. Ndihmësi ligjor ka detyra të tilla që synon të ndihmojë dhe lehtësojë punën e gjyqtarit. Konkretisht, parashikohet



të kryejë veprime procedurale për çështje të thjeshta dhe nën mbikëqyrjen e gjyqtarit. Kjo synon uljen e ngarkesës së punës së gjyqtarit.

Në kuadrin ligjor të zonave gjermanisht folëse ata njihen si "*Rechtspfleger*" apo në Frëngjisht si "*gréffier*". Një nga detyrimet e këtyre të fundit është t'i paraqesë dosjen e një çështjeje gjyqtarit; kur gjyqtari e vazhdon trajtimin e një çështjeje ose tërhiqet prej përfundimit të saj; synon të devijojë nga një mendim i njohur ligjor i gjyqtarit; ai / ajo zbulon çështje faktike ose ligjore; ose për vendimin e *Rechtspfleger*-it dorëzohet një kërkesë për rishqyrtim.

Pasi roli i ndihmësit ligjor është futur rishtazi në kuadrin ligjor Shqiptar, ky ligj parashikon detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili do të organizojë një kurs trajnimi për ndihmësit ligjor brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ai gjithashtu do të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për ndihmësit ligjor të paktën brenda 15 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në nenet 43-49 parashikohen kompetencat e kryesekretarisë, sekretarisë gjyqësore, të shërbimit financiar dhe buxhetor, të marrëdhënies me publikun dhe median, të teknologjisë e informacionit, shërbimit të arkivit gjyqësor, si dhe shërbimet për të garantuar rregullin dhe sigurinë në gjykata.

**Kapitulli V** përbëhet nga 5 seksione dhe përmban nenet 50-82. Njëkëtë kapitull përcaktohen rregulla në lidhje me kushtet dhe kriteret e pranimit dhe emerimit, pezullimin, përgjegjësinë disiplinor të nëpunësve civilë gjyqësor. Projekt-ligji parashikon rregullime të ngjashme me ligjin për nëpunësin civil, i cili madje plotëson kuadrin ligjor në këtë drejtim për çështje që ky projekt-ligj nuk i parashikon. Më konkretisht në seksionet e këtij kapitulli rregullohet si më poshte:

***Seksioni I*** përbëhet nga nenet 50 deri në 56. Në këtë seksion në nenin 50 klasifikohen katëgoritë e nëpunësve civil gjyqësor që kryejnë shërbimet në gjykata të cilat janë kancelari, ndihmësit ligjor, kryesekretaret, sekretaret gjyqësor, nëpunësit civil gjyqësor të angazhuar me e financën dhe buxhetin, si dhe në fusha të tjera të kërkimit ligjor, dokumentacionit, burimeve njërezore, teknologjisë se informacionit, arkivës, marrëdhënieve me publikun dhe me jashtë ose me median. Këtyre nëpunësve civilë gjyqësor statusi u rregullohet me këtë projekt-ligj dhe për çështjet që projekt-ligji referon në ligjin për nëpunësit civil. Ndërkohë punonjësve të tjerë të gjykatës marrëdhënia e punës u rregullohet me Kodin e Punës.

Në nenin 52 parashikohen rregulla më të detjuara për garantimin e formimit fillestar të Kancelarit dhe ndihmësve ligjorë, i cili për kancelarin ofrohet të paktën çdo tre vjet. Për përzgjedhjen në kursin e formimit fillestar zhvillohet provim pranimi. Kandidatët e pranaur ndjekin programin e formimit fillestar, pas të cilit mbi rezultatet e provimit përfundimtar, renditen kandidatët fitues, të cilët janë më tej kandidatët për emërim nga KLGj.

Nenet 54 vendos rregulla për vlerësimin kualifikues të nëpunësve civilë gjyqësor të tjerë në shërbimin gjyqësor. Konkretisht, kompetenca për pranimin e tyre i takon Komisionit të Pranimit pranë Gjykatës.

Neni 55 dhe 56 parashikon kriteret të përgjithshme dhe të vecanta që duhet të plotësojë një kandidat për t'u pranaur në formimi fillestar për kancelar dhe nëpunës civil gjyqësor sipas kategorive që parashikohen në nenin 50.

Sipas pojeqit-ligjit KLGj parashikon rregulla më të detajuara në lidhje me formimin fillestar të Kancelarit dhe ndihmësve ligjorë, vlerësimin kualifikues të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Trajnimet profesionale dhe zhvillimi i personelit të gjykatave është shpesh një nga komponentët kryesor të shumë programeve të reformës gjyqësore në mbarë botën. Personeli i mirë trajnuar i gjykatave krijon realizimin-dhe perceptimin tek përdoruesit e gjykatave- e integritetit gjyqësor dhe transparencën e veprimeve të gjykatave. Ka katër përfitime kryesore për personelin e mirë trajnuar të gjykatave. Së pari, trajnimi efektiv mund të përmirësojë besimin në sistemin e gjykatave, nëpërmjet shërbimit të përmirësuar ndaj klientëve dhe transparencës. Së dyti, trajnimi është thelbësor për efikasitetin procedural dhe menaxhimin e gjykatave, të cilat janë të lidhura direkt me kompetencat e personelit të gjykatës. Pa personel të mirë trajnuar, gjyqtarët do të shpenzonin një sasi të panevojshme të kohës në punët administrative, duke ngadalësuar procesin gjyqësor dhe duke bërë zbatimin e urdhrave të vështirë, në mos të pamundur. Së treti, programet e trajnimit mund të përshtaten në një mënyrë që ndihmon në reduktimin e incidenteve të sjelljes joetike dhe joprofesionale. Së fundi, duke rritur profesionalizmin dhe duke krijuar kompetenca në fusha të tjera, trajnimet do të kenë një efekt përtej detyrave thelbësore të personelit të gjykatës, duke rritur kështu kapacitetin dhe fleksibilitetin e gjykatave (UNDOC, Udhëzues Burimesh për Forcimin e Integritetit dhe kapacitetit Gjyqësor, trajnimi profesional, faqe 24.)

**Seksioni II** përbëhet nga nenet 57 deri në 63. Në këtë seksion parashikohen rregulla për emërimin, periudhën e provës, levizjen paralele, ngritjen në detyrë të nëpunësve civilë gjyqësorë, kancelarin ndihmës ligjorë të Gjykatës. Projekt-ligji parashikon se procesi i emërimit dhe karrierës së nëpunësit civil bazohet në parimet e profesionalizmit, transparencës dhe meritokracisë.

Po ashtu në projekt-ligji parashikohet se kompetenca për të vendosur në lidhje me çështjet emërimi dhe karrierës së kancelarit i takon KLGj, ndërsa për nëpunësit e tjerë civil gjyqësor i takon është Keshillit të Gjykatës. Projekt-ligji reflekton rregulla të ngjashme me ato të parashikuara nga ligji për nëpunësit civil.

**Seksioni III** përbëhet nga nenet 64 deri në 66. Këto nene përcaktojnë të drejtat, detyrat, vlerësimin e punës dhe transferimin e nëpunësve civilë gjyqësorë. Neni 64 parashikon kompetencën e KLGj për të përcaktuar rregulla për kohëzgjatjen e punës së nëpunësve civil, strukturën dhe pagën e nëpunësve gjyqësor civil përveç pagën e kancelarit, që e rregullon vetë ligji.

Neni 65 parashikon vlerësimin e veprimtarisë së nëpunësve civilë gjyqësorë, duke vendosur parimin e vlerësimit periodik. Ky vlerësim bëhet mbi kritere të tilla si: njohuritë profesionale dhe teknike, përkushtimin dhe etikën në punë. Etika e punës është midis këtyre kritereve, pasi rëndësia e personelit etik jo-gjyqësor është njohur edhe nga Parimet e Bangalore-s<sup>1</sup> mbi Sjelljen Gjyqësore, të cilat e ngarkojnë gjyqtarin me mbikëqyrjen e sjelljes së stafit të gjykatës në lidhje me standardet e sjelljes, barazinë, dhe kompetencën e përkushtimit. Në sistemet ku nuk theksohet etika, personeli i gjykatave mund të dëmtojë barazinë e palëve, mund të ngadalësojë

---

<sup>1</sup> Shih Parimet e Bangalore-s për Sjelljen Gjyqësore, Vlera 4: Standardet e sjelljes, Aplikimi 4.15 (kontrolli në lidhje me pranimin e dhuratave apo favoreve); Vlera 5: Barazia, Aplikimi 5.4 (kontrolli në lidhje me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit); Vlera 6: Kompetenca dhe zelli, Aplikimi 6.6 (kontrolli në lidhje me ruajtjen e rendit dhe etikës gjatë procedurave)

proceset gjyqësore dhe të shkatërrojë efikasitetin, dhe mund të jetë një rrugë për korrupsion në gjykata. (UNDOC, Udhëzues Burimesh për Forcimin e Integritetit dhe kapacitetit Gjyqësor, 5. Kodet e sjelljes dhe trajnimi mbi etikën, faqe 30.)

Ky nen parashikon procedurën e kësaj vlerësimi që përfshim dhe vetvlerësimin e kryer nga nëpunësi. Përcakton organët e përfshira në të që këtë proces, siç janë eprori direkt i nëpunësit dhe kryetarin e gjykatës që ben projekt vendimi dhe më pas Këshilli i Gjykatës që merr vendimin. Sa i takon kancelarit është KLGj që vendos në lidhje me vlerësimin e tij.

Neni 66 parashikon transferimin e nëpunësve civil gjyqësor. Ligji për statusin e nëpunësit civil zbatohet për atë që është e mundur edhe për çështje të transferimit të nëpunësit civil gjyqësor. Transferimi i kancelarit është kompetencë e KLGj-së ndërsa për nëpunësit e tjerë civil gjyqësor transferimin e vendos Këshilli i Gjykatës.

**Seksioni IV** përbëhet nga nenet 66 deri në 79. Në këtë seksion parashikohen raste të pezullimit nga detyra të nëpunësit civil, procedura, kohezgjatja, shkaqet dhe efektet financiare të pezullimit. Kompetenca e pezullimit për nëpunësit civil gjyqësor i takon Këshillit të Gjykatës, përveç Kancelarit për të cilin vendos KLGj.

Në nenet 69-71, parashikohen rregulla të detajuara në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve gjyqësor civil, organet kompetente vendimmarrëse, afatet e parashkrimit të shkeljes së pretenduar dhe afatet fillimit të hetimit disiplinor.

Neni 72 parashikon procedurën e hetimit disiplinor, nga nisja e tij deri në vendimarrjen për fillimin e hetimit apo arkivimin e ankesës haptazi të pabazuar.

Nenet 73-74 parashikon rregullat për të garantuar të drejtat e nëpunësit civil përmes një procesi të rregullt ligjor gjatë hetimit disiplinor, zhvillimit të seancës dëgjimore, aksesit në dosje, paraqitjes së provave etj.

Neni 75 parashikon kriteret për caktimin e masave disiplinore. Në të parashikohen rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat nuk janë shterruese që mbahen parasysh në rasti të caktimit të një mase disiplinore.

Nenet 76, 77 dhe 78 parashikojnë rregulla për pezullimin e hetimit disiplinor, të pezullimit nga detyra gjatë hetimit ose procedimit disiplinor, si dhe të drejtën e ankimit të nëpunësit civil gjyqësor.

Neni 79 parashikon rregulla për regjistrimin dhe fshirjen e masave disiplinore nga regjistri qendror i personelit dhe dosja personale e nëpunësit.

**Seksioni V** përbëhet nga nenet 80 deri në 82. Në të parashikohet se rregullat për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin gjyqësor të nëpunësit civil gjyqësor i nënshtrohen atyre të ligjit për nëpunësit civil përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë projektligj. Kompetenca për ndërprerjen e marrëdhënieve të shërbimit gjyqësor së Kancelarit i takon KLGj, ndërsa për nëpunësit e tjerë civil gjyqësor është e Këshillit të Gjykatës. Projekt-ligji parashikon detyrimin e KLGj për të nxjerrë rregulla të hollësishme për procedurën e ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor.

**Kapitulli VI** përbëhet nga nene 83 deri në 97 parashikon dispozitat kalimtare dhe të fundit. Në to projekt-ligji parashikon rregullime për kalimin e statusit të punonjësve

aktualë në gjykata në atë të nëpunësit civil gjyqësor. Qëllimi i projekt-ligjit është garantimi i vazhdimësisë së punonjësve në detyrë duke fituar statusin e nëpunësit civil gjyqësor.

Konkretisht me parashikimin e nenit 83 për kancelarët ata do vazhdojnë të konsiderohen të tillë dhe do i nenshtrohen verifikimit të figurës dhe dhe të kaluarës kriminale dhe shkaqeve të tjera të përjashtimit.

Sipas nenit 84 nëpunësit civilë të Gjykatës së Lartë do të konsiderohen nëpunës civilë gjyqësorë sipas këtij projekt-ligji.

Me parashikimet e nenit 85 ndihmësit ligjor të caktuar nga Ministri i Drejtësisë në gjykatat administrative do të konsiderohen nëpunës civil gjyqësor për efekt të këtij projekt-ligji.

Sipas neneve 86 -87 parashikohen rregullime për fitimin e statusit të nëpunësit civil gjyqësor të punonjësve në gjykata. Për të bërë kalimin e tyre në këtë status i lihet afat dhe detyrë këshillave të gjykatës të përcaktojnë strukturën dhe pozicionet e tyre në përputhje me kategorinë e nëpunësve civil gjyqësor të parashikuar në këtë projekt-ligj.

Dispozitat kalimtare në nenet 89-92, parashikojnë afate për KLGJ për krijimin e regjistrit qëndror të personelit, përcaktuar degët e gjykatave dhe numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve, si dhe për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Nenet 96-101 reflektojnë ndryshime dhe shfuqizime në ligjet ekzistuesë për çështje që trajton ky ligj dhe konkretisht:

- shfuqizime dhe ndryshime në ligjin nr. 9877/2008 Mbi Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar
- ndryshime në ligjin nr 152/2013 “Për Nëpunësin civil”, i ndryshuar
- ndryshime dhe shfuqizime në Ligjin Nr 49/2012 mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative, i ndryshuar
- shfuqizim të Ligjit nr 8588, datë 15 mars 2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

Parashikime të përgjithshme të afateve:

- 0 – hyrja në fuqi
- Brenda muajit të 3të: dërgimi i të dhënave të punonjësve të gjykatës Këshillit të Lartë Gjyqësor, krijimi i Regjistrit të Stafit në KLGJ
- Brenda muajit të 6: plotësimi I Regjistrit të Stafit për stafin e gjykatës
- Brenda muajit të 8: krijimi i KLGJ (projekt ndryshimet e Kushtetutës)
- Brenda muajit të 10: krijimi i Gjykatës së Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar (projekt ndryshimet e Kushtetutës); aktet nën-ligjore për t’u miratuar nga KLGJ
- Brenda muajit të 10 + 2 javë: krijimi i Këshillit të Gjykatës në Gjykatën e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar
- Brenda muajit të 12: verifikimi I pasurisë dhe figures I kancelarëve nga KLGJ + krijimi I Këshillit të Gjykatës, në gjykatat e tjera
- Brenda muajit të 15: vendimet e Këshillave të Gjykatave për statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë

- Brenda muajit të 26: krijimi paraprak I degëve të gjykatës
- Deri më dhjetor 2016: ndihmësit ligjorë do të kalojnë procesin e ri-vlerësimit, do të trajnohen në Shkollën e Magjistraturës, dhe do të marrin përsipër gjithë fushat e kompetencës.